

Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Shtator 2018

Tiranë, më 23 Tetor 2018: Numri i shtetasve shqiptarë dhe të huaj të hyrë në territorin shqiptar, në muajin Shtator 2018, është 1.121.116, krahasuar me Shtator 2017, ky tregues rezulton me rritje 31,5 %.


Në Shtator 2018, numri i shtetasve të huaj të hyrë në vend është 664.184. Krahasuar me Shtator 2017, ky numër është rritur me 44,6 %.

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vendin tonë në nëntëmujorin e 2018 është 5.061.822 duke u rritur me 19,8 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2017.

Në Shtator 2018, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Kosova ka patur rritjen më të madhe me 66,0 %, ulje kanë patur vetëm shtetasit nga Mali i Zi me 16,3 %.

Në nëntëmujorin e 2018, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Polonia ka patur rritjen më të madhe 37,2 % .

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri



Shtetasit shqiptarë dhe të huaj të dalë nga vendi, gjatë muajit Shtator 2018, janë 1.336.203 duke shënuar një rritje me 26,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Shtator 2018, është 515.676 krahasuar me Shtator 2017, ky numër është rritur 3,4 %. Numri i shtetasve të huaj të dalë nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Shtator 2018, është 820.527. Krahasuar me Shtator 2017, ky numër është rritur 48,0 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i vendit tonë në nëntëmujorin 2018, është 4.066.178, duke u rritur 3,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj

Periudha	Shtator 2017	Shtator 2018	Ndryshimi vjetor (%)	Jan-Sht 2017	Jan-Sht 2018	Ndryshimi vjetor progresiv (%)
Hyrje gjithsej	852,743	1.121.116	31,5	7.803.037	8.980.104	15,1
Shqiptarë	393.575	456.932	16,1	3.578.354	3.918.282	9,5
Të Huaj	459.168	664.184	44,6	4.224.683	5.061.822	19,8
Dalje gjithsej	1.053.181	1.336.203	26,9	8.225.250	9.318.188	13,3
Shqiptarë	498.678	515.676	3,4	3.937.855	4.066.178	3,3
Të Huaj	554.503	820.527	48,0	4.287.395	5.252.010	22,5

Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj

Shtetet	Shtator 2017	Shtator 2018	Ndryshim vjetor (%)	Jan-Sht 2017	Jan-Sht 2018	Ndryshimi vjetor progresiv (%)
Kosovë	159.731	265.148	66,0	1.503.594	1.846.372	22,8
Maqedoni	56.720	69.755	23,0	510.001	574.578	12,7
Greqi	40.803	45.535	11,6	351.464	378.301	7,6
Itali	28.122	36.102	28,4	294.447	350.767	19,1
Angli	11.135	12.181	9,4	111.418	99.522	-10,7
Mali i zi	37.650	31.525	-16,3	290.259	256.107	-11,8
Poloni	14.765	28.728	94,6	104.143	142.910	37,2
SHBA	7.616	11.964	57,1	84.462	97.699	15,7
Gjermani	13.059	19.587	50,0	101.807	141.053	38,5
Zvicër	3.381	4.117	21,8	49.032	46.779	-4,6
Të tjera	86.186	139.542	61,9	824.056	1.127.734	36,9
Gjithsej	459.168	664.184	44,6	4.224.683	5.061.822	19,8

Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Periudha	Shtator 2017	Shtator 2018	Ndryshimi vjetor (%)	Jan-Sht 2017	Jan-Sht 2018	Ndryshimi vjetor progresiv (%)
Hyrje Shtetas të Huaj	459.168	664.184	44,6	4.224.683	5.061.822	19,8
I. Personale	452.634	656.680	45,1	4.172.776	4.999.540	19,8
1. Pushime	188.266	343.759	82,6	2.094.930	2.485.304	18,6
2. Vizitë në miq e të afërm	2.927	967	-67,0	15.651	14.304	-8,6
3. Vizitë ditore	74.289	107.550	44,8	239.830	553.337	130,7
4. Trajtim shëndetësor	61	20	-67,2	378	171	-54,8
5. Qëllime fetare	25	69	176,0	487	626	28,5
6. Vizitorë të tjerë	171.703	188.292	9,7	1.678.931	1.791.345	6,7
7. Udhëtarë transit	15.363	16.023	4,3	142.569	154.453	8,3
II. Biznes dhe profesionale	6.534	7.504	14,8	51.907	62.282	20,0

Tab. 4 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit

Periudha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Shtator 2017	113.508	64.516	674.719	151.803	108.681	792.697
Shtator 2018	132.714	81.426	906.976	170.643	116.494	1.049.066
Ndryshimi vjetor (%)	16,9	26,2	34,4	12,4	7,2	32,2
Janar-Shtator 2017	989.749	639.358	6.173.930	1.012.416	689.396	6.523.438
Janar-Shtator 2018	1.148.254	666.484	7.165.366	1.153.281	696.484	7.468.423
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	16,0	4,2	16,1	13,9	1,0	14,5

Metodologji

Përkufizime

Vizitorë: Për qëllime të statistikës së turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”,

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet në kufi.

Hyrjet është një koncept që i referohet të gjitha arritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet : Përfshijnë të gjitha daljet në kufi. Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës.

Qëllimi kryesor i vizitës është qëllimi pa të cilën udhëtimi nuk do të kryhej. Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për arsye:

Vizitat për *qëllime personale*

1. Pushime
2. Vizitë në miq e të afërm
3. Vizitë ditore
4. Trajtim shëndetësor
5. Qëllime fetare
6. Vizitorë të tjerë
7. Udhëtarë tranzit

Kategoria e biznesit përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme (Drejtoria e Policisë së Shtetit).

Të dhënat e muajit të fundit janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/>